



VENDIM

Nr. 77, Datë 07.06.2016

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR
MIRATIMIN E RREGULLAVE TË TREGUT SHQIPTAR TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16; 19 gërma “a” dhe 98 pika 1 të Ligjit nr. 43/2015, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” dhe nenit 25 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 21, datë 18.03.2009, të ndryshuar, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 07.06.2016, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorive teknike të ERE, në lidhje me miratimin e Rregullave të tregut shqiptar të energjisë elektrike”,

Konstatoi:

- Në nenin 98 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, parashikohet se Rregullat e Tregut të Energjisë elektrike të cilat duhet të jenë në harmoni me Modelin e Tregut miratohen nga ERE, pas propozimit të OST sh.a.
- Në nenin 97/3 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, parashikohet se është Këshilli i Ministrave organi përgjegjës që miraton Modelin e Tregut, pas propozimit të tij nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë.
- Në datë 30.03.2016, Këshilli i Ministrave ka miratuar vendimin Nr. 244 “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike.”
- OST me shkresën e saj nr 3299 Prot date 31.05.2016 paraqiti në ERE për miratim draftin e “Rregullave të Tregut”

Për gjithë sa më sipër Bordi i ERE :

Vendosi:

1. Të fillojë procedurat për miratimin e Rregullave të Tregut Shqiptar të Energjisë.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqëritë OSHEE sh.a, KESH sh.a dhe OST sh.a, për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE
Petrit AHMETI